



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Analiza e Pulsit Publik

Sfidat dhe Këndvështrimet e Rinisë në Kosovë

Përpiluar nga UNDP në Kosovë – Ekipi i Projektit Pulsi Publik

Prishtinë

Gusht 2018

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it

Përmbajtja

Përmbajtja	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	7
Metodologjia	8
Rezultatet	8
Perceptimet e të rinjve për perspektivën e Kosovës	8
Migrimi	17
Interesat e të rinjve në arsim	19
Punësimi i të rinjve	28
Perceptimet e të rinjve në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike	45
Të rinjtë që praktikojnë fenë	50
Perceptimet e të rinjve mbi përhapjen e ekstremizmit	53
Perceptimet e të rinjve në lidhje me sigurinë	55
Rekomandime	60
Referencat:	62

Përmbledhje ekzekutive

Si vazhdim i hulumtimit të rregullt të Pulsit Publik, analiza e mëposhtme shtjellon çështjet që lidhen veçanërisht me të rinjtë në Kosovë¹. Synimi është të identifikohen perceptimet, qëndrimet dhe pritjet e rinisë në Kosovë lidhur me kënaqshmërinë e përgjithshme me situatën në Kosovë: migrimin, arsimin, punësimin, marrëdhëniet ndëretnike dhe perspektivat për të ardhmen. Analiza e mëposhtme përfshin opinionet e gjithsej 452 të rinjve, 49.9% femra dhe 51.1% meshkuj. Mosha mesatare e të anketuarve është 22 vjeç (SD = 6.37). Gjithsej 82 persona morën pjesë në grupet e fokusit në Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Graçanicë, Mitrovicë të Veriut, Pejë dhe Prishtinë.

Rezultatet tregojnë se një numër i madh i të anketuarve (48%) janë pesimistë për të ardhmen e Kosovës, sidomos të anketuarit meshkuj (52%). Si sfidën kryesore ndaj perspektivës së tyre në Kosovë, shumica e të anketuarve konsiderojnë mungesën e mundësive për punësim (60%), varfërinë (49.3%), nepotizmin dhe korrupsionin (43%). Nga ana tjetër, të anketuarit nga grupmosha 25-35 vjeç e konsiderojnë situatën e përgjithshme politike si problemin kryesor në Kosovë. Pothuajse 60% e të anketuarve raportuan se ka gjasa që të konsiderojnë largimin nga Kosova në 3 vitet e ardhshme. Të anketuarit shqiptarë të Kosovës, serbë të Kosovës, goranë të Kosovës, boshnjakë të Kosovës dhe egjiptas të Kosovës e quajtën mungesën e mundësive për punësim në Kosovë si arsye kryesore për emigrim, ndërsa të anketuarit turq të Kosovës dhe ashkali të Kosovës përmendën situatën e pafavorshme ekonomike.

Pothuajse 75% e të anketuarve janë *shumë të kënaqur* ose *disi të kënaqur* me arsimin që kanë marrë ose marrin. Megjithatë, 25% e tyre konsiderojnë se arsimi i tyre nuk është i dobishëm për të gjetur punë. Mungesa e profesionalizmit nga mësimdhënësit dhe profesorët (38%) identifikohet si pengesa kryesore në sistemin arsimor, e ndjekur nga infrastruktura e dobët shkollore (28.5%) dhe cilësia e ulët e kurrikulës (28%). Rezultatet tregojnë se 69% e të anketuarve romë të Kosovës nuk i ndjekin shkollat apo universitetet, shifër kjo dukshëm më e lartë se numri i të anketuarve nga komunitetet e tjera etnike që nuk i ndjekin shkollat apo universitetet.

Statusi i punësimit është një tjetër çështje shqetësuese: 56% e femrave dhe 40% e meshkujve të anketuar janë të papunë. Siç u raportua, vetëm 45% e të anketuarve më të rinj (18-24 vjeç), në krahasim me 59% të të anketuarve më të vjetër (25-35 vjeç), aktualisht janë të punësuar.

¹ Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Në total, 48% e të anketuarve janë të papunë dhe vetëm 33%, shumica më të mëdhenj se 18 vjeç, raportojnë se kanë ndonjë përvojë pune. Pothuajse të gjithë të anketuarit konfirmuan se marrin mbështetje financiare: prindërit (55%) dhe anëtarët e tjerë të familjes (46%). Të anketuarit shpjeguan se mungesa e vendeve të punës të disponueshme (43%), korrupsioni (42%) dhe mungesa e kualifikimeve profesionale (41%) e vështirësojnë gjetjen e një pune në Kosovë.

Bashkë me nivelin e lartë të papunësisë, edhe niveli i pesimizmit është i lartë: vetëm 22.3% e të anketuarve kanë "shumë besim" ose "njëfarë besimi" se do të gjejnë punë brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Këtu u identifikuan edhe dallimet gjinore: 46% e femrave dhe 36% e meshkujve të anketuar konsiderojnë se vështirësia për të gjetur një punë i detyrohet mungesës së kualifikimeve profesionale. Të anketuarit e grupmoshës 25-35 vjeç janë më të shqetësuar se nuk do të gjejnë punë që u përshtatet kualifikimeve të tyre, sesa të anketuarit e grupmoshës 18-24 vjeç. Më shumë se 80% e të anketuarve të punësuar janë të kënaqur punën aktuale. Kur u pyetën për sfidat e lidhura me punën, 30% e të anketuarve raportuan se të ardhurat e ulëta janë sfida kryesore në punën e tyre aktuale.

Edhe marrëdhëniet ndëretnike u analizuan. Teksa 28% e të anketuarve pranojnë se gjatë viteve të fundit ka pasur disa përmirësime në marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, 27% mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë ende të tensionuara dhe do të mbeten të tensionuara për një kohë të gjatë. Pak më shumë se 10% e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike nuk janë aq të tensionuara, kurse rreth 7% e të anketuarve pohojnë se marrëdhëniet ndëretnike nuk janë aspak të tensionuara. Më shumë se 45% e të anketuarve të grupmoshës 18-35 vjeç mendojnë se ndikimi i kujtimeve të konfliktit është arsyeja kryesore pse Kosova përballet me situatë të tensionuar në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike. Për të bashkuar të dyja grupet etnike dhe për të kapërcyer tensionet, të rinjtë kanë sugjeruar aktivitete edukative (40.5%). Sa i përket ekstremizmit, shumica e të anketuarve (64%) e konsiderojnë ekstremizmi politik² është më i pranishëm, i ndjekur nga ekstremizmi nacionalist (55%) dhe ekstremizmi fetar (54%). Përkundër përhapjes së lartë të ekstremizmit të perceptuar nga të rinjtë, shumica ende konsiderojnë se gjendja e sigurisë në Kosovë është e qëndrueshme.

² Gjendja ose veprimi i adoptimit të një pikëpamjeje ekstreme

Hyrje

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, pasi 20% e popullsisë vlerësohet të jetë mes 15 dhe 29 vjeç (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018). Në dekadën e fundit, Kosova ka kaluar nëpër sfida të zhvillimit politik, ekonomik dhe social, të cilat kanë ndikuar në mënyra të ndryshme në popullsinë e saj. Teksa rinia konsiderohet si burimi më i madh i vendit, shkalla e lartë e papunësisë së të rinjve e bën të vështirë që të shfrytëzohet plotësisht potenciali i tyre në Kosovë (Myha, 2013). Duke u shoqëruar me papunësi të lartë, disa studime kanë treguar se nivelet e ulëta të pjesëmarrjes së të rinjve në jetën publike, mungesa e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe mungesa e sigurisë janë probleme qendrore në sektorin e të rinjve të Kosovës së pasluftës (Friedrich Ebert Stiftung, 2012). Për më tepër, studimet e kryera në vitet 2006 dhe 2009 treguan se të rinjtë ishin të shqetësuar për cilësinë e arsimit dhe perspektivën e përgjithshme të ardhshme (Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2007, UNDP, 2006). Edhe pse aspiratat për arsim cilësor ishin të larta, niveli i kënaqshmërisë me sistemin arsimor në Kosovë ka qenë relativisht i ulët që nga viti 2006 (Friedrich Ebert Stiftung, 2012). Për fat të keq, të njëjtat sfida, si shkalla e lartë e papunësisë dhe pjesëmarrja e ulët në jetën politike, mbeten edhe në vitin 2018. Mundësitë e të rinjve për të marrë pjesë në politikë, shanset e tyre për prosperitet ekonomik brenda Kosovës dhe qasja e tyre në arsim cilësor mbeten të kufizuara (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë [UNMIK], 2017). Së fundi, segregimi i komuniteteve përgjatë vijave etnike në Kosovë ka implikime për brezin e ri (UNMIK, 2017).

Zhvillimi i kapaciteteve produktive në Kosovë është i një rëndësie kritike, për të reduktuar dobësitë strukturore, për të nxitur rritjen e qëndrueshme, për të rritur pjesëmarrjen e dobishme në tregtinë ndërkombëtare dhe për të arritur një reduktim substancial të varfërisë dhe përmirësime në masë në mirëqenien njerëzore. Meqenëse perceptimet e të rinjve kanë ndikim të rëndësishëm në veprimet që ata do të ndërmarrin në të ardhmen, është e nevojshme të adresohen sfidat ekonomike, arsimore dhe politike. Si i tillë, raporti aktual synon të hulumtojë perceptimet, qëndrimet dhe pritjet e rinisë në Kosovë lidhur me kënaqshmërinë e përgjithshme me situatën në Kosovë, migrimin, arsimin, punësimin, marrëdhëniet ndëretnike dhe perspektivat për të ardhmen. Raporti përmban një analizë përshkuese, e cila siguron dëshmi për përhapjen e fenomenit të lartpërmendur, si dhe statistika inferenciale që tregojnë dallimet sipas gjinisë, moshës dhe grupeve ndëretnike.

Metodologjia


Gjithsej 452 kosovarëve të moshës nga 14 deri në 35 vjeç, të përzgjedhur përmes mostrimit me etapa të shumëfishta dhe probabilitet të rastësishëm, morën pjesë në këtë anketë në Janar 2018. Mostra përfshiu 204 shqiptarë të Kosovës, 150 serbë të Kosovës dhe 98 pjesëtarë të pakicave të tjera të Kosovës (përkatësisht turke, boshnjake, gorane, rome, ashkali dhe egjiptiane) Në këtë numër të përgjithshëm të të anketuarve, 49.9% ishin femra dhe 51.1% ishin meshkuj. Moshë mesatare e të anketuarve ishte 22 vjeç (SD = 6.37). Sa i përket arsimit, 52% e të anketuarve frekuentonin shkollën ose universitetin, ndërsa 48% nuk ishin aktualisht në ndonjë program formal të arsimit. Në total, 48% e të anketuarve janë të papunë dhe nuk fitojnë të hyra, ndërsa 52% e të anketuarve që janë të punësuar fitojnë mesatarisht 304 euro në muaj. Studim përdori edhe shtatë grupe të fokusit, me gjithsej 82 të rinj nga Prizreni, Gjilani, Mitrovica, Graçanica, Mitrovica e Veriut, Peja dhe Prishtina. Të dhënat u analizuan duke përdorur Paketën Statistikore për Shkencat Shoqërore (SPSS) dhe analizën tematike për përmbajtjen e grupeve të fokusit. Diskutimet në grupet e fokusit ofruan një shpjegim më të hollësishëm të perceptimeve të të rinjve lidhur me perspektivën e Kosovës në katër fusha kryesore: gjendja socio-ekonomike dhe politike, feja dhe siguria ndëretnike, arsimi dhe pritshmëria për të ardhmen. Duke përfituar nga diversiteti i opinionëve nga këto grupe fokusi, mund të nxirret një konsensus rreth pikave të synuara të këtij projekti.

Rezultatet

Perceptimet e të rinjve për perspektivën e Kosovës

Në përgjithësi, ky studim tregoi se të rinjtë janë pesimistë për të ardhmen e Kosovës. Gjithsej, 48% e të anketuarve mendojnë se Kosova nuk po ecën as drejtimin e duhur e as në atë të gabuar. Mes 52% të mbetur, shumica besojnë se Kosova është në rrugën e gabuar (32%), ndërsa 9.5% janë të bindur se Kosova po ecën në drejtimin e duhur. Rezultatet treguan dallime të konsiderueshme gjinore në lidhje me perspektivën e Kosovës: 52% e të anketuarve meshkuj, në krahasim me 45% të të anketuarve femra, konsiderojnë se Kosova nuk po ecën as drejtimin e duhur e as në atë të gabuar. Kur u pyetën për perceptimin e përgjithshëm të situatës politike në grupet e fokusit, shumica e të anketuarve kishin një qëndrim negativ.


Figura 1. Opinioni i të anketuarve në lidhje me drejtimin që po ecën Kosova (vlerat në përqindje)



Diskutimi i grupeve të fokusit ofroi një debat interesant rreth perspektivës së përgjithshme të Kosovës. Studentët që nuk e kanë përfunduar universitetin shfaqën predispozitë më të madhe për të migruar në vendet perëndimore në të ardhmen e afërt sesa ata pjesëmarrës që e kanë përfunduar arsimin e lartë. Në përgjithësi, pjesëmarrësit shfaqën qëndrime negative lidhur me të ardhmen në Kosovë. Ata pretendojnë se Kosova nuk po ecën në drejtimin e duhur dhe se kjo nuk do të ndryshojë në vitet e ardhshme. Pjesëmarrësit paraqitën disa zgjidhje për këtë problem, siç janë: liberalizimi i vizave, zgjedhjet e reja dhe përmirësimet në sistemin arsimor dhe shëndetësor. Ndryshe nga të anketuarit nga rajone të tjera të përfshira në këtë projekt, të anketuarit nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, doli të ketë qëndrimet më pozitive në lidhje me çështjet e paraqitura. Ata e shohin të ardhmen e Kosovës si një vend që do t'u japë mundësi të vërteta të gjithëve për të përmbushur potencialet e tyre personale. Megjithatë, vlen të përmendet se shumica e këtyre të anketuarve raportojnë se janë në punë dhe janë të kënaqur me jetën e tyre në Kosovë. Si pjesë e hulumtimit sasior, të anketuarve ia kërkua të vlerësojnë sfidat më të mëdha për bashkëmoshatarët e tyre që jetojnë në Kosovë. Shumica e të anketuarve (60.1%) e konsideronin mungesën e mundësive për punë si sfidën kryesore (Figura 2). Ata gjithashtu vlerësuan varfërinë (49.3%) dhe nepotizmin/korrupsionin (43.0%) në vendin e dytë dhe të tretë të sfidave me të cilat aktualisht ballafaqohen të rinjtë kosovarë. Gjithashtu, u vërejtën dallimet gjinore në çështjen e sfidave më të mëdha për kosovarët. Gjashtë për qind e femrave i konsiderojnë ideologjitë radikale si problemin më të madh në Kosovë, krahasuar me vetëm një për qind të meshkujve që mendonin të njëjtën gjë. Për më tepër, analiza aktuale zbuloi disa dallime të rëndësishme në baza etnike: 73%

e romëve të Kosovës dhe 69% e të anketuarve shqiptarë të Kosovës e konsiderojnë mungesën e mundësive për punësi si problemin kryesor në Kosovë, ndërsa të anketuarit e etnive të tjera nuk e kanë raportuar këtë të jetë një sfidë e ngutshme. Shumica e turqve të Kosovës (83%) dhe romëve të Kosovës (78%) e konsiderojnë varfërinë si sfidën kryesore, ndërsa pjesëtarët e etnive të tjera jo.


Figura 2. Mendimet e të anketuarve për sfidat më të mëdha me të cilat ata po ballafaqohen (vlerat në përqindje)



Pjesëmarrësit në grupet e fokusit i shihnin situatën politike, papunësinë dhe migrimin si probleme të përbashkëta në Kosovë. Ata gjithashtu përmendën fenomene të tjera njësoj të pakënaqshme, siç janë: nepotizmi, korrupsioni, kujdesi shëndetësor dhe sistemi arsimor. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit e përshkruan veçanërisht nepotizmin si fenomen demotivues që po krijon një atmosferë të mungesës së shpresës; ata dyshojnë se çështjet e mësipërme do të përmirësohen në Kosovë. Për shembull: më shumë se 40% besojnë se është disi e pamundur (38.5%) ose ka shumë pak gjasa (4%) që cilësia e arsimit në Kosovë do të përmirësohet gjatë dy viteve të ardhshme. Së fundi, një e treta besojnë se qasja në punësi nuk do të përmirësohet.


Krahas analizës përshkruese, u krye edhe krahasimi mes grupeve. Më shumë të anketuar nga grupmosha 25-35 vjeç e konsiderojnë gjendjen e përgjithshme politike dhe korrupsionin si problemet kryesore në Kosovë sesa të anketuarit nga grupmosha 18-24 vjeç.

Figura 2.1. Mendimet e të anketuarve për sfidat më të mëdha me të cilat ata ballafaqohen, sipas moshës (vlerat ne përqindje)




Sa i përket votimit, shumica e të anketuarve mbi moshën 18 vjeç votojnë, pasi më shumë se 56% dalin të votojnë në zgjedhjet kombëtare dhe lokale. Më shumë se 56% e të anketuarve kanë raportuar se kanë dalë të votojnë në zgjedhjet kombëtare dhe lokale. Nuk kishte dallime gjinore në këtë drejtim. Megjithatë, më shumë se 19% kanë raportuar se ndonjëherë votojnë dhe ndonjëherë nuk e bëjnë këtë. Pak më shumë se 16% e të anketuarve thanë se nuk votojnë fare. Të anketuarit më të rinj (18-24 vjeç) kanë raportuar shkallë më të ulëta të votimit sesa të anketuarit më të vjetër (25-35 vjeç). Për sa i përket etnisë, shumica e romëve të Kosovës (78%) dhe shqiptarëve të Kosovës (73%) dalin të votojnë, ndërsa përqindja e serbëve të Kosovës është e ulët (30.5%).

Figura 3. Praktikët e votimit të të anketuarve (vlerat në përqindje)




Të anketuarit e konsiderojnë shëndetin fizik dhe mendor (49%), marrëdhëniet familjare (43%) dhe sigurinë financiare (31%) si faktorë shumë të rëndësishëm në jetën e tyre. Arsimi konsiderohet "jashtëzakonisht i rëndësishëm" nga 28% e të anketuarve, 36.3% konsiderojnë se shkolla dhe studimi janë "shumë të rëndësishëm", ndërsa vetëm 12.6% pohojnë se shkolla ka "pak rëndësi" në jetën e tyre. Sa i përket miqësisë, 26.3% e të anketuarve e konsiderojnë atë "jashtëzakonisht të rëndësishme", 38.3% "shumë të rëndësishme" dhe vetëm 9.1% e të anketuarve kanë raportuar se miqësia ka "pak rëndësi" në jetët e tyre. Marrëdhëniet familjare kanë një vend të rëndësishëm në jetën e të rinjve në Kosovë, ku 43.1% kanë deklaruar se marrëdhëniet familjare i konsiderojnë me "rëndësi ekstreme", 29.4% kanë deklaruar se marrëdhëniet familjare janë "shumë të rëndësishme" dhe më pak se 9% konsiderojnë se marrëdhëniet familjare kanë pak rëndësi në jetët e tyre. Figura 4 tregon se shëndeti fizik dhe mendor është çështja më e rëndësishme për të anketuarit: mbi 73% e konsiderojnë ose si "jashtëzakonisht të rëndësishëm" (48.7%) ose "shumë të rëndësishëm". Siguria financiare është gjithashtu e një rëndësie të madhe për të anketuarit: më shumë se 30% deklaruan se është "jashtëzakonisht e rëndësishme", 38.5% e konsiderojnë "shumë të rëndësishme" dhe vetëm 10% pohojnë se siguria financiare ka pak rëndësi në jetët e tyre. Të dhënat e zbërthyer sipas etnisë tregojnë se numri më i madh i të anketuarve që konsiderojnë se arsimi nuk është i rëndësishëm është mes ashkalinjve të Kosovës (17%) dhe goranëve të Kosovës (8%). Numri më i madh i të anketuarve që e konsiderojnë sigurinë financiare shumë të rëndësishme është mes romëve të Kosovës dhe turqve të Kosovës. Nuk kishte dallime gjinore lidhur me gjërat më të rëndësishme në jetën e të anketuarve.

Figura 4. Përgjigjet e të anketuarve në lidhje me gjërat më të rëndësishme në jetët e tyre (vlerat në përqindje)



Të dhënat e zërthyer sipas moshës tregojnë se 8% e të anketuarve nga grupmosha 25-35 vjeç konsiderojnë se arsimi nuk është i rëndësishëm dhe se vetëm 3% e të anketuarve nga dy kategoritë e tjera të moshës (14-17 dhe 18-24 vjeç) pajtohen me këtë përgjigje.

Figura 4.1. Përgjigjet e të anketuarve në lidhje me rëndësinë e arsimit, të dhënat sipas moshës (vlerat në përqindje)




Të anketuarit u pyetën edhe për brengosjen e tyre nga një seri dukurish negative në Kosovë. Figura 5 tregon se përballimi i stresit është çështja e parë që sjell brengosje të lehtë deri në të skajshme për 70.4% të të anketuarve. Figura 5 gjithashtu tregon se më shumë se 50% e të anketuarve kanë deklaruar se janë nga paksa deri tepër të brengosur nga problemet e punës, diskriminimi dhe problemet e shkollës.

Diskutimet në grupet e fokusit treguan se komuniteti që perceptohet si më i diskriminuar në Mitrovicë është komuniteti ashkali i Kosovës. Një nga pjesëmarrësit pohoi se profesorët në shkollën e tij përdorin shprehje përcmuese ndaj komunitetit ashkali.


Çështje të tilla si martesë e hershme, bixhozi dhe konfliktet familjare perceptohen si më pak brengosëse, edhe pse mbeten probleme të cilave shoqëria kosovare duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë. Ekziston një dallim i konsiderueshëm gjinor në lidhje me perceptimet e problemeve të punës: 64% e të anketuarve meshkuj dhe vetëm 54% e të anketuarave femra janë të brengosur për problemet e punës në Kosovë.

Figura 5. Brengosja e të anketuarve nga një sërë dukurish negative në Kosovë (vlerat në përqindje)




Të dhënat e zërthyera sipas moshës treguan se ballafaqimi me stresin është brenga kryesore për grupin 25-35 vjeç, ndërsa pjesëmarrësit nga dy grupmoshat e tjera u shprehën se kjo të jetë një çështje më pak brengosëse (Figura 5.1).

Figura 5.1. Brengosja e të anketuarve nga stresi, të dhënat sipas moshës (vlerat në përqindje)



Pirja e duhanit është veprimi më i zakonshëm që të anketuarit kanë raportuar se kanë parë mes shokëve të tyre gjatë 12 muajve të fundit. Pothuajse 52% e të anketuarve u përgjigjën se shokët e tyre pinë duhan, ndërkohë që 33% e tyre i kanë parë miqtë e tyre duke pirë alkool. Braktisja e shkollës është një çështje tjetër shqetësuese. Në total, 29.5% e të anketuarve raportuan se shokët e tyre kanë braktisur shkollën gjatë 12 muajve të fundit. Përdorimi i drogës dhe lojërat e fatit janë gjithashtu ndër sjelljet e rrezikshme më shpesh të raportuara. Shpërndarja e përgjigjeve sipas gjinisë, moshës dhe kategorive kombëtare është e ngjashme, dhe nuk ka dallime domethënëse


Figura 6. Raportimi i të anketuarve për miqtë që janë përfshirë në sjellje të rrezikshme ose veprime të pahijshme (gjatë 12 muajve të fundit) (vlerat në përqindje)



Migrimi

“A mund të na thoni nëse do ta konsideroni të migroni brenda tre viteve të ardhshme?” ishte pyetja e shtruar për të identifikuar tendencat e migrimit në mesin e të rinjve në Kosovë. Gjithsej, 27% e pjesëmarrësve janë përgjigjur me siguri se do të konsideronin migrimin, ndërsa 31% kanë raportuar se ka gjasa që ta konsiderojnë largimin nga Kosova në tre vitet e ardhshme. Vetëm rreth 18% kishin besim se nuk do ta konsideronin migrimin si opion gjatë periudhës së lartpërmendur.

Figura 7. Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsiderojnë migrimin brenda tre viteve të ardhshme (vlerat në përqindje)



Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike treguan qëndrime shumë të ndryshme, sepse pakicat treguan tendenca më të larta për migrim. Egjiptasit e Kosovës (71%), ashkalinjtë e Kosovës (50%), boshnjakët e Kosovës (50%) dhe romët e Kosovës (44%) deklaruan se patjetër do ta konsideronin migrimin. Vetëm 37.8% e të anketuarve shqiptarë të Kosovës dhe vetëm 1.1% e atyre serbë deklaruan se patjetër do ta konsideronin migrimin.


Tabela 1. Gatishmëria e anketuarve për migrim, të dhëna sipas përkatësisë etnike (vlerat në përqindje)

	Shqiptar i Kosovës	Serb i Kosovës	Boshnjak i Kosovës	Goran i Kosovës	Turk i Kosovës	Rom i Kosovës	Ashkali i Kosovës	Egjiptas i Kosovës
Patjetër do ta konsideroja migrimin	37,8	1,1	50	25	33,3	44,4	50	71,4
Ka gjasa të konsideroja migrimin	31,9	28,4	50	37,5	33,3	33,3	37,5	14,3

Mungesa e mundësive për punësim (55%) në Kosovë u rendit si arsyeja kryesore pse të rinjtë do të largoheshin nga Kosova. Situata e pafavorshme ekonomike në familje, niveli i ulët i të ardhurave individuale dhe mungesa e perspektivës personale janë tre kategoritë e para që kanë marrë 38% dhe 31% të votave të të anketuarve mes arsyeve përse do të largoheshin nga Kosova. Pakënaqësia me gjendjen politike, mungesa e arsimit cilësor dhe mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor në Kosovë janë gjithashtu ndër arsyet më të raportuara për migrim. Të dhënat e zërthyera sipas etnisë treguan motivime të ndryshme për migrim: shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës, goranët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës dhe egjiptasit e Kosovës do të emigronin për shkak të mungesës

së mundësive për punësim në Kosovë. Kurse të anketuarit turq të Kosovës dhe ashkali të Kosovës do ta bënin këtë për shkak të situatës së pafavorshme ekonomike, përkatësisht paga e ulët dhe të ardhurat e pafavorshme mujore të familjes. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë dhe moshës nuk treguan dallime të konsiderueshme në përgjigje.


Figura 8. Arsyet kryesore për migrim të të anketuarve (vlerat në përqindje)



Interesat e të rinjve në arsim


Një tjetër fushë e interesit në këtë studim ishte arsimit në mesin e të rinjve kosovarë. Studimi hulumtoi nivelin e arsimit, duke përfshirë kënaqshmërinë e të rinjve me cilësinë e arsimit. Figura 9 tregon se 52% e të anketuarve ndjekin shkollën ose universitetin dhe se 48% aktualisht nuk ndjekin asnjë program formal të arsimit. Në total, 69% e të anketuarve romë të Kosovës nuk ndjekin shkollën apo universitetin, shifër kjo dukshëm më e lartë se numri i të anketuarve që nuk i ndjekin shkollat apo universitetet nga etnitë e tjera.

Figura 9. Përqindja e të anketuarve që ndjekin shkollën/studimet universitare




Përveç kësaj, kemi hulumtuar përvojat rinore në lidhje me përfshirjen sociale në shkolla. Gjithsej, 82% e të anketuarve thanë se nuk ndihen si të huaj në shkollate tyre dhe 70% u shprehën se nuk e kanë problem të bëjnë miq. Mbi 70% e të anketuarve kanë ndjenjë të përkatësisë në shkollate tyre, ndërsa pothuajse 80% nuk pajtohen aspak ose nuk pajtohen kur u pyetën nëse është e vërtetë që ndihen të vetmuar në shkollën e tyre. Megjithatë, nuk duhet të injorohet që 15% e të anketuarve ndihen si të huaj në shkollat e tyre, mbi 27% e të anketuarve e kanë të vështirë të bëjnë miq në shkollë, rreth 25% e tyre ndihen sikur nuk i përkasin shkollave të tyre, dhe pothuaj 20% e të anketuarve deklaruan se ndiheshin të vetmuar në shkollë. Nuk kishte dallime gjinore në lidhje me këtë dimension.

Figura 10. Përgjigjet e të anketuarve në lidhje me ndjenjat ose situatën e tyre në shkollë (vlerat në përqindje)



Të anketuarit treguan aspirata të larta drejt arsimimit. Shumica e të anketuarve që janë në shkollë (51%) u përgjigjën se dëshirojnë të përfundojnë së paku një program bachelor, mbi 15% aspirojnë të përfundojnë një program master dhe 4% aspirojnë të përfundojnë një doktoraturë. Përfundimi i shkollës së mesme është një aspiratë për 28% të të anketuarve, ndërsa më pak se 1% e të anketuarve duan të braktisin shkollimin formal pas përfundimit të shkollës fillore. Nuk ka dallime gjinore në lidhje me këtë dimension. Megjithatë, analiza statistikore zbuloi dallime të rëndësishme mes etnive. Aspirata më e lartë për arsimimin e ardhshëm u identifikua mes të anketuarve shqiptarë dhe serbë të Kosovës, ndërsa aspiratat më të ulëta për arsimimin e ardhshëm ishin në mesin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve të Kosovës.

Figura 11. Aspiratat arsimore të të anketuarve (vlerat ne përqindje)



Kur u pyetën për pengesat kryesore që nuk u lejojnë të ndjekin arsimin e lartë, 28% e të anketuarve e cilësuan mungesën e parave si pengesë të rëndësishme dhe 8% si pengesë kryesore për të ndjekur universitetin. Nuk kishte dallime gjinore në këtë drejtim. Megjithatë, 32% e të anketuarve nuk i konsiderojnë paratë si problem për arsimim të mëtejshëm. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nuk shohin notat e dobëta në shkollë si një barrierë të rëndësishme për arsimin pas shkollës së mesme, 43% deklaruan se notat shkollore nuk janë pengesë fare, 29% i konsiderojnë një pengesë të vogël dhe 17% e të anketuarve i konsiderojnë si pengesë të rëndësishme. Mbi 55% të të anketuarve nuk u mungon përkrahja familjare kur bëhet fjalë për avancimin në arsimimin e tyre. Si e tillë, mbështetja e familjes është një pengesë e rëndësishme vetëm për rreth 15% të të anketuarve dhe një pengesë e madhe për 8.3% të të anketuarve. Mos pasja e parave të mjaftueshme për të ndjekur arsimin e lartë është pengesa kryesore për shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe të anketuarit egjiptas të Kosovës.

Figura 12. Perceptimi i anketuarve mbi pengesat që nuk u lejojnë të ndjekin arsimin e lartë (vlerat në përqindje)





Figura 13 ilustron arsyet pse disa nga 48% e të anketuarve kanë braktisur shkollën dhe nuk kanë vazhduar shkollimin e tyre. Pothuajse një e treta (30%) e të anketuarve e kanë braktisur shkollën ose nuk e kanë vazhduar arsimin formal për arsye financiare, dhe iu është dashur të plotësojnë të hyrat e familjes në vend të shkollës. Fillimi i familjes ishte arsyeja për 27% të të anketuarve që vendosën të mos e vazhdonin shkollimin e tyre. Çuditërisht, 12% e të anketuarve janë larguar nga shkolla sepse nuk shohin ndonjë përfitim në avancimin e arsimimit të tyre. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan dallime të konsiderueshme në përgjigje. Për shembull, më shumë femra (9%) sesa meshkuj të anketuar (2%) i raportuan shpenzimet e transportit si arsye që i shtyn ta lënë shkollën. Gjithashtu, më shumë femra (40%) sesa meshkuj (15%) deklaruan se fillimi i familjes ishte arsyeja pse kanë braktisur shkollën. Në të kundërt, 37% e të anketuarve meshkuj deklaruan se arsyeja kryesore për braktisjen e shkollës ishte se ata duhej të punonin për të plotësuar të ardhurat e familjes së tyre, ndërsa kjo ishte e vërtetë vetëm për 23% të të anketuarve femra. “Unë duhet të punoj për të plotësuar të ardhurat e familjes”, është arsyeja kryesore për braktisjen e shkollës për shumicën e të anketuarve në grupmoshën ndërmjet 18 dhe 24 vjeç. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve që kanë braktisur shkollën për shkak se kanë filluar familjen e vet i përkasin grupmoshës mes 25 dhe 35 vjet. Të dhënat e zbërthyer sipas etnisë treguan se fillimi i

një familjeje ishte arsyeja kryesore për braktisjen e shkollës për shqiptarët e Kosovës (37%) dhe romët e Kosovës (33%). Të anketuarit e etnive të tjera raportuan se arsyeja kryesore për braktisjen e shkollës ishte sepse ata duhej të punonin për të plotësuar të ardhurat e tyre familjare.

Figura 13. Arsyet e të anketuarve për braktisjen e shkollës (vlerat në përqindje)




Një shqetësim tjetër i zbuluar gjatë punës së grupeve të fokusit ishte ankthi i shkaktuar nga pabarazia mes numrit të të diplomuarve të rinj dhe vendeve të lira të punës. Kjo vetëm konfirmon gjetjet e mëparshme të këtij studimi se problemet ekonomike janë shqetësimi kryesor në Kosovë. Këto shqetësime shtrihen edhe në fushën e arsimit. Shumë pjesëmarrës deklaruan se i kanë braktisur studimet e tyre të gjendur mes mungesës së të ardhurave dhe mungesës së vendeve të punës me kohë të pjesshme. Megjithatë, ata gjithashtu thanë se nuk kishin çfarë të bënin:

“Një nga vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë nga Kosova gjatë arsimimit është fakti se ata nuk mund të punojnë dhe të studiojnë në të njëjtën kohë, dhe për këtë arsye shumica e tyre nuk mund të vetë-financohen. Vetëm në raste të rralla dikush mund ta financojë veten gjatë arsimit. Edhe atëherë, puna ndërhyr në mënyrë drastike me shkollimin e tyre, duke bërë që të kenë rezultate të dobëta në studimet e tyre. Arsyeja pse është pothuajse e pamundur të punohet dhe të studiohet në të njëjtën kohë në Kosovë është se shumica e institucioneve dhe kompanive private nuk ofrojnë punë me kohë të pjesshme,” sipas një pjesëmarrësi në Gjilan.

“Unë punoj dhe studioj, por puna ime ka ndikuar në notat e mia, sepse kam mbetur prapa në përfundimin e kurseve. Puna më la mbrapa në arsim,” pjesëmarrës në Pejë.


Pyetja tjetër kishte për qëllim të hulumtonte nivelin e kënaqshmërisë me cilësinë e arsimit në Kosovë. Në total, 74% e të anketuarve janë shumë të kënaqur ose disi të kënaqur me arsimin që kanë marrë ose janë duke marrë. Nga ana tjetër, 23% janë disi të pakënaqur ose nuk janë aspak të kënaqur me cilësinë e arsimit që kanë marrë. Analiza statistikore tregoi se grupet etnike më të pakënaqur me cilësinë e arsimit janë romët e Kosovës dhe ashkalinjtë e Kosovës. Analizat e mëtejshme nuk treguan dallime të rëndësishme sipas gjinisë dhe moshës.

Figura 14. Kënaqshmëria e të anketuarve me cilësinë e arsimit që kanë marrë ose marrin (vlerat në përqindje)




Pjesëmarrësit në grupet e fokusit kishin pikëpamje të ndryshme për cilësinë e arsimit në Kosovë. Disa prej tyre thanë se cilësia e arsimit në Kosovë është në nivel shumë të ulët, ndërsa pjesa tjetër e renditi në të njëjtin nivel si arsimi evropian. Shumica e ankesave për cilësinë e arsimit kanë të bëjnë me kualifikimet joadekuate të profesorëve që japin mësim në universitete dhe në shkolla të mesme. Disa pjesëmarrës deklaruan se profesorët e tyre kanë nga dy punë dhe e konsiderojnë punën në institucionin publik si punë sekondare. Veçanërisht, u theksua mungesa e materialeve të përshtatshme studimore në universitete. Kjo është veçanërisht problematike për studentët që nuk kanë njohuri të gjuhës angleze dhe nuk mund të konsultojnë burime në atë gjuhë. Kur u pyetën për vlerën e diplomave të tyre, një përqindje relativisht e vogël e të anketuarve mendonin se diploma e tyre ishte shumë e dobishme për të gjetur punë (15%). Arsimi ishte disi i dobishëm për 48% të të anketuarve, por mbi 30% e të anketuarve konsiderojnë se arsimimi i tyre nuk është i dobishëm. Nuk ka pasur dallime të rëndësishme në përgjigje kur zërthehen sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike.

Figura 15. Mendimet e të anketuarve për dobinë e arsimimit të tyre (vlerat në përqindje)




Të anketuarit identifikuan mungesën e profesionalizmit nga mësimdhënësit/profesorët si pengesën kryesore me të cilën përballen gjatë arsimimit (38%). Edhe infrastruktura e dobët shkollore (28.5%) dhe cilësia e ulët e programeve studimore (28%) u konsideruan si pengesa të rëndësishme. Më shumë se 20% e të anketuarve, mes sfidave renditën edhe vlerësimin nga mësimdhënësit/profesorët, mungesën e literaturës dhe klasat e mbingarkuar.

Figura 16. Tri pengesat kryesore që hasin ose kanë hasur të anketuarit gjatë arsimimit (vlerat në përqindje)



Dy të tretat e të anketuarve meshkuj dhe femra konfirmuan se kanë dëgjuar për aftësimin profesional, por 33% i mbetur thanë se nuk kanë dëgjuar për këtë lloj trajnimi. Në total, vetëm 36% e të anketuarve konsiderojnë se trajnimi profesional mund të jetë shumë i dobishëm. Megjithatë, mbi 55% e të anketuarve u përgjigjën "Po" kur u pyetën nëse qasja e përmirësuar në aftësimin profesional do të ishte e dobishme në drejtim të ofrimit të mundësive për punësim për rininë kosovare. Mungesa e informacionit është ndoshta arsyeja që pothuajse 30% e të anketuarve u përgjigjën "Nuk e di" në këtë pyetje.


Figura 17. Përgjigjet e të anketuarve nëse ata kanë dëgjuar për aftësimin profesional



Punësimi i të rinjve


Një total prej 52% e të anketuarve janë të punësuar: 36% me orar të plotë, 10.5% me kohë të pjesshme dhe 6% janë të vetëpunësuar. Në total, 48% e të anketuarve janë të papunë. Ndër të anketuarit që nuk punojnë, 26% nuk punojnë por kërkojnë punë, ndërsa 22% as nuk punojnë dhe as nuk kërkojnë punë. Të gjithë prej 22% të të anketuarve që nuk punojnë dhe nuk kërkojnë punë janë studentë. Të dhënat e zbërthyera sipas moshës treguan dallime të mëdha në përgjigje. Vetëm 45% e të anketuarve më të rinj (18-24 vjeç) në krahasim me 59% të të anketuarve më të vjetër (25-35 vjeç) janë të punësuar. Nuk ka dallime të konsiderueshme mes etnive.

Figura 18. Statusi aktual i punësimit i të anketuarve (vlerat në përqindje)




Analiza statistikore zbuloi dallime të rëndësishme gjinore në lidhje me punësimin: 56% e të anketuarave femra dhe 40% e të anketuarve meshkuj nuk janë të punësuar. Gjithashtu, 30% e të anketuarave femra as nuk punojnë dhe as nuk janë në kërkim të një pune, në krahasim me vetëm 13.9% të të anketuarve meshkuj që janë në të njëjtën situatë.

Figura 18.1. Statusi aktual i punësimit i të anketuarve, të dhënat sipas gjinisë (vlerat në përqindje)




Arsyeja kryesore që të rinjtë e papunë nuk janë në kërkim të vendeve të punës është sepse ata shkojnë në shkollë ose së pari duan të mbarojnë shkollën (48%). Përgjegjësitë familjare, siç është kujdesi për fëmijët, janë arsyeja e dytë më e shpeshtë (25%) për mos kërkimin e një pune, e ndjekur nga mungesa e kualifikimeve të duhura (12%). “Nuk ka punë në këtë zonë” është përgjigjja e dhënë nga 10.8% e të anketuarve, ndërsa 6% kanë deklaruar se nuk kërkojnë punë sepse nuk dinë ta bëjnë këtë.

Figura 19. Arsyet e të anketuarve për të mos kërkuar punë (vlerat në përqindje)



Pothuajse të gjithë të anketuarit deklaruan se prindërit ose anëtarët e familjes së tyre i mbështesin financiarisht: 55% mbështeten nga prindërit e tyre, 46% nga anëtarët e tjerë të familjes dhe 18.5% nga të afërmit/miqtë që jetojnë jashtë vendit. Vetëm 1.5% e të anketuarve pretendojnë se kanë mbështetje nga institucionet e Kosovës. Analizat krahasuese treguan dallime të konsiderueshme gjinore në lidhje me mbështetjen e anëtarëve të tjerë të familjes ku të anketuarat femra (54%) janë më të varura nga ndihma familjare sesa meshkujt (29%). Mbështetja nga familja konsiderohet si burimi kryesor financiar për pjesëmarrësit më të rinj (79%), ndërsa kjo është e vërtetë vetëm për 22% të pjesëmarrësve më të vjetër (25-35 vjeç).

Figura 20. Origjina e të ardhurave financiare/qëndrueshmërisë financiare të të anketuarve (vlerat në përqindje)



Vetëm një e treta e të anketuarve raportuan të kenë përvojë pune (33%), ndërsa 67% janë pa ndonjë përvojë në tregun e punës.

Figura 21. Përvoja punës e të anketuarve






Figura 21.1 tregon se më shumë të anketuar meshkuj (38%) sesa femra (30%) kanë përvojë pune.

Figura 21.1 Përvoja e punës së të anketuarve, të dhënat sipas gjinisë (vlerat në përqindje)



Duke qenë se janë pa përvojë pune dhe nuk kanë mundësi të mira pune, rreth 30% e pjesëmarrësve deklaruan se do të konsideronin një punë me të ardhura të ulëta, kurse 21% deklaruan se nuk do ta bënin. Shumica (47%) nuk kanë besim nëse do të konsideronin një punë me të ardhura të ulëta. Analizat krahasuese nuk treguan dallime të rëndësishme në përgjigjet sipas gjinisë, moshës apo përkatësisë etnike.

Figura 22. Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsideronin një punë me të ardhura të ulëta



Diskutimet në grupet e fokusit dhanë më shumë informacion të thelluar rreth perceptimeve rreth punësimit dhe sfidave që lindin gjatë tranzicionit drejt punësimit. Shumica e pjesëmarrësve në grupet e fokusit ishin të punësuar dhe e konsideronin punën si një nga faktorët kryesorë në jetën e tyre. Shumë që shprehën pakënaqësi me punën e tyre, pagat e tyre ishin shumë të ulëta. Të tjerë deklaruan se puna e tyre aktuale përputhet me diplomën që kanë marrë në universitet ose në shkollat e tjera profesionale. Janë vërejtur dallime në mënyrën se si pjesëmarrësit shpjeguan mungesën e përshtatshmërisë ndërmjet kualifikimeve dhe vendeve të punës. Pjesëmarrësit që përcaktojnë pikat e forta personale si përparësi dhe që e shohin punësimin si rezultat i përkushtimit të tyre, shprehën një vizion optimist për gjetjen e punës në të ardhmen, në krahasim me ata pjesëmarrës që ia atribuuan papunësinë e tyre sistemit të papërshtatshëm.

“E kam një punë. Në fillim të kërkimit tim kam vizituar çdo institucion që ka lidhje me arsimimin tim dhe e kam lënë CV-në time, dhe në fund kam arritur të gjej punë. Tani po punoj në një organizatë amerikane në Prishtinë; kam gjashtë vjet përvojë pune,” pjesëmarrës në Prishtinë.

“Nuk punoj sepse nuk kam lidhjet e duhura. Në Kosovë, mund të gjesh punë vetëm përmes partisë politike në pushtet. Kështu ka qenë prej vitesh. Përvoja dhe arsimi nuk kanë rëndësi për marrjen e një punë,” pjesëmarrës në Graçanicë.

“Jam duke kërkuar punë, por më duhet të gjej disa lidhje që të më ndihmojnë ta kap, sepse pa lidhje është e pamundur të gjesh punë”, pjesëmarrës në Graçanicë.

Kur u pyetën se çfarë ndodhi herën e fundit që punuan, 38% e të anketuarve u përgjigjën se kontrata e tyre ishte ndërprerë, 32% thanë se kishin kontratë afatshkurtër, 19% u larguan nga puna për shkak të pagës joadekuate dhe 17% dhanë dorëheqje për arsye personale ose familjare.

Figura 23. Përvojat e të anketuarve në punën e tyre të fundit






Figura 24 tregon se 21% e të anketuarve kanë refuzuar dhe 46% nuk kanë refuzuar kurrë një ofertë pune. Gjithashtu, kjo figurë tregon se 33% e të anketuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Figura 24. Përgjigjet e të anketuarve nëse kanë refuzuar ndonjëherë një punë




Arsyeja kryesore pse të anketuarit kanë refuzuar ofertën e punës ishte për shkak të kushteve të pakënaqshme të ofertës (76%), 21% treguan se refuzimi ishte për shkak të qëllimeve të ndryshme profesionale dhe 3% ofruan arsye të tjera për refuzimin e një pune. Vetëm 5% e të anketuarve kanë thënë se kanë qenë nën presion nga kolegët, shoqëria ose familjet që të aplikojnë për një punë më fitimprurëse dhe të injorojnë zhvillimin e tyre profesional. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve (62%) deklaruan se nuk kanë refuzuar kurrë një punë. Nuk ka dallime domethënëse mes gjinive, grupmoshave ose etnive në lidhje me këtë aspekt.

Figura 25. Arsyet kryesore të të anketuarve për refuzimin e një pune (vlerat në përqindje)




Në pyetjen pse është e vështirë për të gjetur një vend pune në Kosovë, arsyeja më e shpeshtë ishte mungesa e vendeve të punës (43%), pasuar nga korrupsioni (42%), mungesa e kualifikimeve profesionale të kërkuara (41%), mungesa e nivelit të kërkuar të përvojës në punë (38%), nepotizmi në procesin e përzgjedhjes (37%), rënia e kërkesës për punësim në fushën e shkathtësive (21%) dhe diskriminimi me bazë etnike (17%), të cilat shihen si disa nga shkaqet kryesore të vështirësive për të siguruar punësim. Çështje të tilla si besimet fetare dhe diskriminimi gjinor (përkatesisht 3%) nuk janë aq të shpeshta. U identifikuan dallimet gjinore: 46% e të anketuarave femra dhe 36% e të anketuarave meshkuj mendonin se mungesa e kualifikimeve profesionale është arsyeja kryesore pse është e vështirë të sigurohet punësimi.

Figura 26. Opinonet e të anketuarve përse është vështirë të sigurohet punësimi



Zbërthimi i të dhënave sipas etnisë tregoi opinione paksa të ndryshme lidhur me faktorët që vështirësojnë sigurimin e punësimit, të cilat kryesisht përqendrohen në punët e disponueshme dhe perceptimin e korrupsionit. Ndërkohë që të gjithë egjiptasit e Kosovës konsiderojnë se korrupsioni është sfida kryesore për sigurimin e punësimit, 86% e ashkalinjve të Kosovës, 50% e goranëve të Kosovës, 38% e serbëve të Kosovës dhe 37% e shqiptarëve të Kosovës e konsiderojnë korrupsionin si sfidë për punësim.

Figura 26.1. Opinioni i anketuarve mbi korrupsionin si sfidë për punësimin, të dhënat sipas përkatësisë etnike (vlerat në përqindje)



Niveli i lartë i papunësisë është i lidhur me nivelin e lartë të pesimizmit që përshkon procesin e gjetjes së një pune brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Vetëm 22% e të anketuarve kanë shumë besim ose njëfarë besimi se do të gjejnë punë në gjashtë muajt e ardhshëm. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve nuk kanë aspak besim (38%) ose kanë pak besim (35.5%) se do të gjejnë punë në gjashtë muajt e ardhshëm. Shqiptarët e Kosovës treguan nivelin më të lartë të pesimizmit, pasi analiza tregon se 60% e shqiptarëve të Kosovës, 43% e ashkalinjve të Kosovës dhe 33% e romëve të Kosovës nuk kanë besim se mund të gjejnë punë brenda gjashtë muajve të ardhshëm.

Figura 27. Besimi i të anketuarve në gjetjen e një pune në gjashtë muajt e ardhshëm (vlerat në përqindje)






Figura 27.1 tregon të dhënat e zbrëthyera sipas gjinisë mbi besimin e të anketuarve rreth gjetjes së një pune në gjashtë muajt e ardhshëm. Të anketuarit meshkuj janë më të bindur se do të gjejnë punë në gjashtë muajt e ardhshëm sesa të anketuarat femra.

Figura 27.1. Dallimet gjinore në lidhje me besimin e anketuarve se do të gjejnë punë në gjashtë muajt e ardhshëm (vlerat në përqindje)




Sa i përket preferencave për punë të të anketuarve, 62% e të anketuarve preferojnë të punojnë në sektorin publik, 24% preferojnë të gjejnë punë në sektorin privat dhe 5.3% preferojnë të punojnë në organizatat e shoqërisë civile ose të jenë të vetëpunësuar. Analiza për krahasimin e vlerave mesore nuk tregoi dallime të rëndësishme sipas gjinisë, moshës apo etnisë.

Figura 28. Preferencat për punë të të anketuarve (vlerat në përqindje)




Megjithëse mbi 60% e të anketuarve thanë se preferonin të punonin në sektorin publik, 66.5% e të anketuarve që pohuan se e kishin një punë deklaruan se punojnë në sektorin privat, pak më shumë se 20% punojnë në sektorin publik, 10% janë të vetëpunësuar, dhe rreth 3% pohojnë se punojnë për organizatat e shoqërisë civile.

Figura 29. Lloji i punësimit të të anketuarve (vlerat në përqindje)



Paga është faktori kryesor përcaktues pse 47% e të anketuarve do të konsideronin të punonin në një fushë që nuk ka lidhje me ekspertizën e tyre. Nga ana tjetër, vetëm 9% e të anketuarve thanë se do të refuzonin një ofertë të një pune që nuk lidhet me profesionin e tyre, dhe 10.5% e të anketuarve nuk e dinë nëse do ta konsideronin. Analiza për krahasimin e vlerave mesore nuk tregoi dallime të rëndësishme sipas gjinisë, moshës apo etnisë.


Figura 30. Gadishmëria e të anketuarve për të konsideruar një punë që nuk lidhet me profesionin e tyre (vlerat në përqindje)



Të anketuarit u pyetën edhe për llojin e aktiviteteve që i ofrojnë vullnetarisht. Ndihma për të organizuar ose drejtuar ngjarje apo aktivitete është aktiviteti më i shpeshtë (35.5%) i papaguar që


kryejnë të anketuarit. Fushatat, përfaqësimi i komunitetit, dhe puna në zyrë apo puna administrative u renditën mes aktiviteteve të tjera shpesh të papaguara që kryhen nga 24% deri në 28% e të anketuarve. Aktivitetet më pak të papaguara ishin ato që synonin të ndihmonin aktivitetet arsimore, trajnimi, ose stërvitje (14.5%). Sa u përket dallimeve gjinore, rezultatet tregojnë se femrat priren të përfshihen shumë më tepër në fushatë (81%) krahasuar me meshkujt (64%), që është ndryshimi i vetëm i rëndësishëm në lidhje me aktivitetin e papaguar.

Figura 31. Aktivitetet vullnetare/të papaguara të të anketuarve (vlerat në përqindje)




Të anketuarit u pyetën edhe për sfidat më të mëdha ndaj punësimit. Shumica e të anketuarve (45.5%) konsiderojnë se sfida kryesore është gjetja e një pune që i përshtatet kualifikimit ose shkathtësive të tyre, dhe rreth 35% mendojnë se mungesa e përvojës së punës është sfida më e madhe. Së fundi, një e katërta e të anketuarve pajtohen se procesi i rekrutimit është një sfidë e vërtetë kur kërkon punë. Pjesëmarrësit më të vjetër (25-35 vjeç) janë më të shqetësuar ssesa pjesëmarrësit më të rinj (18-24 vjeç) se nuk mund të gjejnë një punë që është e përshtatshme për kualifikimet e tyre.

Figura 32. Sfida më e madhe ndaj gjetjes së punës sipas të anketuarve (vlerat në përqindje)




Kur u pyetën për të përshkruar nivelin e kënaqshmërisë me punën e tyre aktuale, 65% e të anketuarve pohuan se janë disi të kënaqur me atë që bëjnë, 17% pohuan se ishin shumë të kënaqur me punën e tyre, vetëm 5% thanë se nuk janë aspak të kënaqur dhe 9% deklaruan se janë disi të pakënaqur me punën aktuale.

Figura 33. Kënaqshmëria e të anketuarve me punën e tyre aktuale (vlerat në përqindje)




Të anketuarat femra kanë tendencë të raportojnë kënaqësi më të madhe me punën e tyre aktuale, në krahasim me të anketuarit meshkuj. Figura 33.1 tregon se vetëm 12% e të anketuarve meshkuj dhe 23% e të anketuarve femra kanë raportuar të jenë shumë të kënaqur me punën e tyre aktuale.

Figura 33.1. Dallimet gjinore në lidhje me kënaqshmërinë me punën (vlerat në përqindje)




Ky studim gjithashtu kishte për qëllim identifikimin e sfidave me të cilat përballen të rinjtë në punën e tyre. Rreth 30% e të anketuarve raportuan të ardhurat e ulëta si sfidën kryesore, 26% e të anketuarve identifikuan se duhet të punojnë në kushte të këqija të punës, dhe 21% mungesën e kualifikimeve profesionale ose shkathtësive adekuate për punën. Mungesa e sigurimit shëndetësor (20%) dhe mungesa e trajtimit të drejtë nga punëdhënësit (17%) janë disa sfida të tjera të identifikuara nga të rinjtë e punësuar.

Figura 34. Sfidat kryesore me të cilat përballen të rinjtë në punën e tyre



Sipas 83% të të anketuarve, arsyeja kryesore pse ata nuk punojnë në profesionin e tyre është mungesa e mundësive në fushën përkatëse të ekspertizës. Megjithatë, 33% pretendojnë të kenë kuptuar se kanë më shumë afinitet për llojin e punës që po bëjnë aktualisht. Analiza për krahasimin e vlerave mesore nuk tregoi dallime të rëndësishme sipas gjinisë, moshës apo etnisë.

Figura 35. Opinonet e të anketuarve për arsyen pse nuk punojnë në profesionin e tyre (vlerat në përqindje)



Perceptimet e të rinjve në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike

Një tjetër fushë kyçe e hulumtimit ishte identifikimi i perceptimeve të të rinjve në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike. “Cili nga përshkrimet e mëposhtme të marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës të moshës tuaj është më i afërt me pikëpamjen tuaj?” ishte pyetja e parashtruar. Përafërsisht 27% mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe se kjo situatë do të mbetet e njëjtë. Nga ana tjetër, 28% e të anketuarve i përshkruan këto marrëdhënie si të tensionuara, por sipas tyre ka pasur disa përmirësime të arritura gjatë viteve të fundit. Pak më shumë se 10% mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike nuk janë aq të tensionuara dhe rreth 7% e të anketuarve pohojnë se këto marrëdhënie nuk janë aspak të tensionuara. Nuk ka dallime gjinore.

Figura 36. Opinioni i anketuarve në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike mes komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në Kosovë (vlerat në përqindje)




Tabela 1 tregon se të anketuarit me prejardhje të ndryshme etnike kanë pikëpamje të ndryshme mbi marrëdhëniet ndëretnike mes komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në Kosovë. Një numër i lartë i shqiptarëve të Kosovës (30.4%) konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe do të mbeten të tilla. Gjithashtu, një përqindje e konsiderueshme e komunitetit serb të Kosovës (27%) konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara, por janë bërë përmirësime të konsiderueshme.

Tabela 2. Opinioni i anketuarve në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike mes komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në Kosovë, të dhënat sipas përkatësisë etnike (vlerat në përqindje)


	Shqiptar i Kosovës	Serb i Kosovës	Boshnjak i Kosovës	Goran i Kosovës	Turk i Kosovës	Rom i Kosovës	Ashkali i Kosovës	Egjiptas i Kosovës
Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do të vazhdojnë të mbeten të tilla	30,4	25,3	0	6,3	0	22,2	25	14,3

Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë bërë disa përmirësime gjatë viteve të fundit	32,6	25,3	0	12,5	0	38,9	31,3	14,3
Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë bërë përmirësime të konsiderueshme	8,9	27,4	50	12,5	66,7	16,7	18,8	14,3
Marrëdhëniet nuk janë aq të tensionuara	8,1	9,5	0	37,5	0	0	6,3	42,9
Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	6,7	5,3	0	18,8	0	5,6	6,3	0
Nuk e di	9,6	2,1	50	6,3	33,3	11,1	12,5	14,3
Pa përgjigje/REF	3,7	5,3	0	6,3	0	5,6	0	0

Diskutimet e grupeve të fokusit zbuluan se ndryshe nga shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës e perceptojnë situatën ndëretnike si shumë të tensionuar. Ata thonë se janë të diskriminuar, ndihen të pasigurt dhe se shqiptarët e Kosovës nuk duan të mbajnë marrëdhënie të mira me ta. Serbët e Kosovës besojnë se një zgjidhje për këtë situatë do të ishin aktivitetet ndëretnike të ndërsjella, të cilat, sipas tyre, mungojnë. Historia e kohëve të fundit³ është burimi kryesor i informacionit (35.5%) për vlerësimin e të rinjve të marrëdhënieve ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Një tjetër burim i rëndësishëm në këtë drejtim janë mediat (28%). Tregimet dhe përvojat nga miqtë dhe të afërmit kanë ndikuar në mendimin e 24% të të anketuarve, ndërsa 12.5% pohojnë se kanë dhënë vlerësimin e tyre në bazë të përvojave personale. Analiza për krahasimin e vlerave mesore nuk tregoi dallime të rëndësishme sipas gjinisë, moshës apo etnisë.

³Termi "histori e kohëve të fundit" përdoret për të përshkruar kohët e fundit, kryesisht duke iu referuar periudhës 1990 - 2010.

Figura 37. Përgjigjet e të anketuarve se ku e bazojnë vlerësimin e marrëdhënieve mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës (vlerat në përqindje)



Shumica e shqiptarëve të Kosovës e kanë formuar opinionin e tyre mbi marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në bazë të historisë së kohëve të fundit (31%) dhe raportimit të mediave (28%). Serbët e Kosovës i konsiderojnë këto dy burime si burimet kryesore për vlerësimin e këtyre marrëdhënieve (32%).


Tabela 3. Përgjigjet e të anketuarve se ku e bazojnë vlerësimin e marrëdhënieve mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, të dhënat sipas përkatësisë etnike (vlerat në përqindje)

	Shqiptar i Kosovës	Serb i Kosovës	Boshnjak i Kosovës	Goran i Kosovës	Turk i Kosovës	Rom i Kosovës	Ashkali i Kosovës	Egjiptas i Kosovës
Përvoja personale	17	5,3	50	18,8	0	0	8,7	18,2
Tregime dhe përvoja nga miqtë dhe të afërmit	23,7	29,5	0	25	0	3,8	13	0
Historia e kohëve të fundit	31,1	32,6	50	31,3	0	50	30,4	18,2
Raportimi i mediave	28,1	32,6	0	25	0	15,4	17,4	27,3

Kur u pyetën për arsyt kryesore që kontribuojnë në marrëdhëniet mes komuniteteve të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës, 45% e të anketuarve raportuan ndikimin e kujtimeve të konfliktit. Për më tepër, mungesa e gatishmërisë së serbëve të Kosovës për t'u integruar në shoqërinë kosovare (37%) dhe ndikimi nga gjeneratat e vjetra që kanë përjetuar konfliktin (33%) besohet të jenë arsyt kryesore që kontribuojnë në marrëdhëniet e tensionuara. Ka dallime të mëdha ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në lidhje me pikëpamjet e tyre mbi arsyt kryesore që kanë kontribuar në situatën e tensionuar. Teksa 64% e shqiptarëve të Kosovës mendojnë se kujtimet e konfliktit janë faktorët më me ndikim, kjo është e vërtetë vetëm për 12% të serbëve të Kosovës.

Studimi gjithashtu hulumtoi mendimet e të anketuarve për mënyrat më të mira për të përmirësuar marrëdhëniet mes të rinjve serbë dhe shqiptarë të Kosovës. Të anketuarit sugjeruan përdorimin e një qasjeje edukuese dhe që i ekspozon të dyja grupet ndaj informacionit të saktë rreth konfliktit (40.5%), zhvillimin e një programi ndëretnik të arsimit (36.5%), pjesëmarrja si e shqiptarëve të Kosovës ashtu edhe e serbëve të Kosovës në aktivitete të përbashkëta (25%), tolerancën dhe mirëkuptimin për njëri tjetrin (23%), frekuentimi i një shkolle të integruar nga shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës (19%). Përdorimi i një qasjeje edukuese si mënyra kryesore për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës perceptohet si zgjidhje nga 59% e shqiptarëve të Kosovës dhe nga vetëm 15% e serbëve të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës ndajnë pak a shumë të njëjtin opinion për të gjitha alternativat e tjera.

Figura 37.1. Përgjigjet e të anketuarve për mënyrat si të përmirësohen marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës (vlerat në përqindje)




Përveç identifikimit të problemeve të përbashkëta në Kosovë, pjesëmarrësit në grupet e fokusit propozuan edhe mënyra për të kapërcyer marrëdhëniet e tensionuara ndëretnike. Propozimet e përgjithshme përfshinin kryesisht përmirësimin ekonomik, pasi të anketuarit konsiderojnë se rritja ekonomike dhe mundësitë e reja të punësimit mund t'i zvogëlojnë tensionet. Një tjetër perspektivë e përshkruar në grupet e fokusit ka të bëjë me perceptimin e marrëdhënieve ndëretnike. Kosovarët shprehën qëndrime pozitive ndaj të gjitha etnive, duke përfshirë serbët etnikë, përveç grupit të fokusit në Pejë, ku disa pjesëmarrës shqiptarë të Kosovës thanë se nuk duan të dëgjojnë asnjëri që flet serbisht dhe se nuk janë të gatshëm të jetojnë së bashku me pjesëtarët e komunitetit serb.

Të rinjtë që praktikojnë fenë


Të anketuarit u pyetën edhe për përkatësinë e tyre fetare. Në total, 76% e të anketuarve e praktikojnë fenë: 16% në baza të rregullta, 36% e praktikojnë fenë kohë pas kohe, 24% shumë rrallë dhe 16% e të anketuarve nuk e praktikojnë fare. Analiza për krahasimin e vlerave sipas gjinisë, moshës apo etnisë, nuk tregoi dallime të rëndësishme.

Figura 38. Frekuenca e ushtrimit të fesë nga të anketuarit (vlerat në përqindje)




Dyzet e dy për qind e të anketuarve pajtohen dhe 27% pajtohen disi me pikëpamjet fetare të prindërve të tyre. Vetëm 3% e të anketuarve nuk pajtohen aspak me prindërit e tyre për pikëpamjet e tyre fetare. Sa për mësimdhënësit, vetëm 28% e të anketuarve pajtohen plotësisht me ta, 36% pajtohen, 10.8% disi nuk pajtohen dhe 6% e të anketuarve nuk pajtohen aspak me pikëpamjet fetare të mësimdhënësve të tyre. Bashkëmoshatarët/miqqtë pajtohen shumë më shumë me njëri tjetrin për pikëpamjet fetare: 33% e të anketuarve pajtohen plotësisht, 36.5% pajtohen disi, 12% disi nuk pajtohen dhe 5% nuk pajtohen aspak me pikëpamjet fetare të shokëve dhe miqve të tyre. Mbi 31% e të anketuarve duket se pajtohen plotësisht me pikëpamjet fetare të partnerëve të tyre dhe vetëm 4% e të anketuarve nuk pajtohen aspak me partnerin e tyre për pikëpamjet e tij/saj fetare.

Figura 39. Niveli i pajtimit të të anketuarve për fenë me prindërit, mësimdhënësit, bashkëmoshatarët/shokët dhe partnerët (vlerat në përqindje)



Shumica e të anketuarve (35%) pajtohen se ndikimi i bashkësisë fetare është substancial, por jo vendimtar për aktivitetet e tyre në zonën ku ata jetojnë. Rreth 18% e pjesëmarrësve besojnë se bashkësia fetare ka ndikim të fuqishëm në zonën e tyre. Nga ana tjetër, 19% mendojnë se komuniteti fetar ka një ndikim të vogël dhe 11% ndajnë mendimin se bashkësia fetare nuk ka fare ndikim në zonën e tyre.


Figura 40. Opinioni i të anketuarve për ndikimin e bashkësisë fetare në zonën e tyre (vlerat në përqindje)



Perceptimet e të rinjve mbi përhapjen e ekstremizmit


Pjesëmarrësit në studim u pyetën edhe për perceptimin e tyre mbi përhapjen dhe llojin e ekstremizmit në Kosovë. Sipas mendimit të tyre, ka një përhapje shumë të lartë të ekstremizmit. Më shumë se 20% ndajnë mendimin se ekstremizmi politik është "shumë i përhapur", 41% besojnë se kjo formë e ekstremizmit është "disi e përhapur", ndërsa 14.5% pajtohen se ekstremizmi politik "nuk është aspak i përhapur". Ekstremizmi nacionalist është "shumë i përhapur" në Kosovë sipas 13% të të anketuarve dhe "disi i përhapur" sipas 42%. "Nuk është aspak i përhapur" është përgjigjja e ofruar nga 19% e të anketuarve. Ashtu si ekstremizmi nacionalist, 13% e të anketuarve mendojnë se ekstremizmi fetar është "shumë i përhapur". Gjithsej, 40.5% besojnë se ekstremizmi fetar është disi i përhapur, ndërsa 26% e të anketuarve ndajnë mendimin se nuk ka përhapje të ekstremizmit fetar në Kosovë. Nuk ka dallime mes gjinive, grupmoshave ose etnive në lidhje me këtë dimension.

Figura 41. Opinioni i anketuarve në lidhje me ekstremizmin fetar, politik dhe nacionalist në Kosovë (vlerat në përqindje)



Media është burimi kryesor i informacionit për shumicën e të anketuarve (56%) në lidhje me nivelet e ekstremizmit fetar. Një pjesë tjetër prej 19% e kanë krijuar mendimin e tyre nga tregimet personale. Krahasimi i vlerave mesatare nuk tregoi dallime të rëndësishme sipas gjinisë, moshës apo etnisë.

Figura 42. Përgjigjet e të anketuarve në lidhje me burimet për opinionet e tyre për nivelin e ekstremizmit fetar në Kosovë (vlerat në përqindje)




Grupet e fokusit shtjelluan diskutime rreth nivelit të ekstremizmit në Kosovë. Diskutimi mbështeti gjetjet nga aspektet sasiore të hulumtimit. Shumica e pjesëmarrësve nga të gjitha komunat pohuan se e praktikojnë fenë dhe se feja luan një rol të rëndësishëm në zgjedhjet e përditshme të jetës së tyre, si dhe i ndihmon në promovimin e paqes dhe tolerancës. Përkundrazi, pjesëmarrësit nga komunat me shumicë serbe deklaruan se kanë dalluar përhapjen e dukshme të ekstremizmit fetar në Kosovë, veçanërisht nga feja islame.

Perceptimet e të rinjve në lidhje me sigurinë

Duket se lagjet dhe shkollat janë dy nga mjediset më të sigurta për 70% të të anketuarve. Vendi i punës është i sigurt ose deri diku i sigurt për 52% të të anketuarve, dhe dalja jashtë konsiderohet e sigurt ose deri diku e sigurt nga 56% e të anketuarve në këtë studim.

Figura 43. Ndjenjat e të anketuarve në lidhje me sigurinë brenda lagjes së tyre, në shkollë, në vendin e punës dhe gjatë daljeve (vlerat në përqindje)



Ka dallime të konsiderueshme etnike në perceptimin e sigurisë, pasi të anketuarit serbë të Kosovës kanë raportuar nivelin më të lartë të pasigurisë në krahasim me etnitë e tjera.


Tabela 4. Ndjenjat e të anketuarve në lidhje me sigurinë brenda lagjes së tyre, të dhënat sipas përkatësisë etnike (vlerat në përqindje)

	Shqiptar i Kosovës	Serb i Kosovës	Boshnjak i Kosovës	Goran i Kosovës	Turk i Kosovës	Rom i Kosovës	Ashkali i Kosovës	Egjiptas i Kosovës
Shumë i sigurt	56,9	2,7	0	70,8	63,6	65,4	43,5	81,8
Disi sigurt	35,8	32,7	100	16,7	9,1	19,2	26,1	9,1
Disi i pasigurt	4,4	52	0	8,3	18,2	11,5	26,1	0
Shumë i pasigurt	1	2,7	0	4,2	0	3,8	4,3	9,1
Nuk e di/Refuzoj	2	10	0	0	9,1	0	0	0

Institucionet e nivelit qendror të Kosovës nuk po bëjnë mjaftueshëm për të garantuar siguri në rrugë, sipas 30% të të anketuarve. Përafërsisht e njëjta përqindje e të anketuarve (31%) konsideron se institucionet e Kosovës nuk po bëjnë mjaftueshëm për të garantuar siguri efektive në vendet e tyre të punës. Nga ana tjetër, rreth një e treta besojnë se institucionet publike nuk kanë bërë mjaftueshëm për të garantuar siguri në lagje dhe në rrugë.

Në diskutimin e grupeve të fokusit, grupet e shumicës serbe të Kosovës, si dhe adoleshentët e Mitrovicës së jugut, e perceptojnë sigurinë si problemin kryesor. Serbët e Kosovës deklarojnë se marrin mbështetje të kufizuar nga institucionet lokale, prandaj ata mbështeten më shumë në përkrahjen nga institucionet në Serbi. Adoleshentët shqiptarë të Kosovës në pjesën jugore të Mitrovicës shprehën shqetësim dhe pasiguri të madhe kur kalojnë në pjesën veriore të Kosovës për shkak të konfliktit të mundshëm që mund të gjenerohet nga grupet e serbëve të Kosovës.


Figura 44. Opinionet e të anketuarve për përkushtimin e institucioneve të nivelit qendror në Kosovë për të siguruar mjedis të sigurt në rrugë, vendet e punës, shkolla dhe lagje (vlerat në përqindje)



Pritshmëritë në lidhje me të ardhmen

Duke u bazuar në perceptimet e të anketuarve për të ardhmen e të rinjve në Kosovë, vetëm 3% mendojnë se ka shumë gjasa që të rinjtë të kenë një jetë më të mirë pas pesë vjetësh. Megjithatë, 10% janë të bindur se kjo nuk ka aspak gjasa të ndodhë. Deri diku ka gjasa për 44% të të anketuarve, edhe pse 38% mendojnë se është disi e pamundur që të rinjtë kosovarë të kenë një jetë më të mirë se sot.

Figura 45. Opinioni i të anketuarve për jetën më të mirë për të rinjtë në të ardhmen (vlerat në përqindje)




Dallimet sipas gjinisë, në lidhje me opinionet e tyre për të ardhmen, nuk janë të mëdha.

Tabela 5. Opinonet e të anketuarve për jetën më të mirë në të ardhmen, të dhënat sipas gjinisë (vlerat në përqindje)

	Meshkuj	Femra
Ka shumë gjasa	2,6	3,2
Disi ka gjasa	44,6	42,5
Disi nuk ka gjasa	37,2	38
Nuk ka aspak gjasa	10,8	10

Edhe më pesimist është opinioni i të anketuarve rreth mundësive të përmirësimit të situatës politike dhe ekonomike, pasi më shumë se 40% e të anketuarve mendojnë se këto përmirësime nuk mund të ndodhin. Ekziston një dallim domethënës mes grupmohave në lidhje me perceptimet e situatës politike: 55% e të anketuarve më të rinj, në krahasim me vetëm 42% të të anketuarve më të rritur, janë optimistë për situatën politike në të ardhmen.

Figura 46. Pritjet e të anketuarve për përmirësimin e jetës në Kosovë (vlerat në përqindje)



Numri më i madh i pjesëmarrësve me pikëpamje pesimiste në lidhje me përmirësimin në të gjitha aspektet e jetës në Kosovë është mes serbëve të Kosovës, pasuar nga boshnjakët e Kosovës, ashkalinjtë e Kosovës dhe romët e Kosovës.

Tabela 5. Pritjet e të anketuarve për përmirësimin e jetës në Kosovë, të dhënat sipas etnicitetit

Përqindja	Shqiptar i Kosovës	Serb i Kosovës	Boshnjak i Kosovës	Goran i Kosovës	Turk i Kosovës	Rom i Kosovës	Ashkali i Kosovës	Egjiptas i Kosovës
Ka shumë gjasa	5,9	2	0	25	27,3	7,7	13	81,8
Disi ka gjasa	59,3	29,3	50	45,8	63,6	57,7	39,1	18,2
Disi nuk ka gjasa	27,9	55,3	50	25	0	34,6	39,1	0
Ka shumë pak gjasa	3,9	4,7	0	0	0	0	4,3	0

Diskutim

Kosova është përballur me sfida, në shumë aspekte dhe kjo rrit pakënaqësinë e të rinjve. Sipas gjetjeve të këtij hulumtimi, shumë kosovarë të rinj e konsiderojnë të pashpresë situatën në Kosovë. Rinia kosovare kryesisht ka opinione negative ndaj situatës aktuale në Kosovë. Shumica e të anketuarve deklaruan se situata në Kosovë po ecën në drejtimin e gabuar. Ata identifikuan tri probleme kryesore: mungesën e mundësive për punë, situatën e pafavorshme ekonomike në familje/të ardhurat e ulëta dhe mungesën e perspektivës personale. Në përgjigjet tyre, 27% e të rinjve të Kosovës treguan se do ta shfrytëzonin shansin e parë që u jepet për migrim brenda tri viteve të ardhshme. Mbi 55% e të anketuarve renditën papunësinë si arsye kryesore për t'u larguar nga Kosova. Hulumtimi aktual konfirmoi edhe gjetjet e mëparshme që kanë treguar një shkallë të lartë të papunësisë në Kosovë (47%). Këto të dhëna përputhen mirë me të dhënat e paraqitura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018), sipas të cilave 56% e të rinjve në Kosovë janë të papunë. Sa u përket marrëdhënieve ndëretnike, të anketuarit e rinj konsiderojnë se marrëdhëniet ndërmjet të pjesëtarëve të rinj të komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës janë të tensionuara dhe se duhet bërë shumë për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike. Përafërsisht 45% pajtohen se çështjet si kujtimet e konfliktit ende ndikojnë dhe kontribuojnë në marrëdhëniet e tensionuara. Përfundimisht, perspektiva e të rinjve për të ardhmen ishte kryesisht negative, me vetëm 9.5% që besonin se Kosova është duke ecur në drejtimin e duhur dhe 32% që besojnë se Kosova është në rrugën e gabuar.

Rekomandime

Për të adresuar sfidat kryesore dhe për të forcuar perspektivën e rinisë në Kosovë, ofrohen rekomandimet e mëposhtme:

- Institucionet e Kosovës duhet të promovojnë zhvillimin ekonomik, të zvogëlojnë varfërinë dhe të luftojnë nepotizmin dhe korrupsionin.
 - Institucionet e Kosovës dhe autoritetet lokale duhet të ofrojnë strategji për të luftuar korrupsionin dhe nepotizmin, të cilat u identifikuan si sfida kryesore nga të rinjtë e Kosovës.
 - Të rinjtë inkurajohen të përfshihen në programe dhe fushata të ndryshme kundër varfërisë, nepotizmit dhe korrupsionit.
- Institucionet e Kosovës inkurajohen fuqimisht që të zbatojnë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, veçanërisht pikën 1. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, pika 3. Lidhje më e

mirë mes sistemit arsimor dhe tregut të punës dhe pika 7. Trajtimi i punësimit informal dhe krijimi i kushteve adekuate të punës.

- Institucionet e Kosovës duhet të intensifikojnë përpjekjet e bazuara në dëshmi për të nxitur zhvillimin në Kosovë.
- Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë plane dhe dokumente të reja strategjike për punësimin e të rinjve në Kosovë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë në mesin e të rinjve.
 - Kërkohen veprime të mëtejshme nga institucionet e Kosovës për të forcuar sektorin privat (legjislacioni, promovimi i eksporteve, disponueshmëria e kredisë) duke ofruar më shumë mundësi për punësimin e të rinjve në këtë sektor.
- Rinia në Kosovë duhet të inkurajohet fuqimisht për të zhvilluar plane dhe strategji për të forcuar pozicionin e tyre dhe për të rritur shkallën e tyre të punësimit.
- Institucionet e Kosovës, partitë politike, organizatat joqeveritare (OJQ) dhe shoqëria civile duhet të zhvillojnë fushata të reja dhe programe të ndërhyrjes që inkurajojnë të rinjtë në Kosovë të marrin pjesë në zgjedhjet lokale dhe kombëtare.
- Institucionet e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të zhvillojnë projekte të reja ndërhyrëse që synojnë reduktimin e stresit, problemeve të punës, diskriminimit dhe problemeve shkollore.
- Duhet të konsiderohet punësimi i psikologëve në shkolla si një mënyrë për të përmirësuar shëndetin mendor të të rinjve dhe për të zvogëluar nivelin e stresit të identifikuar si çështja kryesore e brengosjes të skajshme nga të rinjtë.
- Institucionet e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të zhvillojnë programe të reja që mundësojnë migrimin ligjor për punë në vendet e Evropës Perëndimore, duke marrë parasysh tendencat e larta të migrimit të raportuara nga të rinjtë. Duke ditur se arsyeja kryesore për migrim është situata e pafavorshme ekonomike, institucionet e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të, shoqërinë civile dhe bizneset, duhet të krijojnë programe për migrimin ligjor të punësimit qarkullues, i cili është një lëvizje e përkohshme e punëtorëve migrantë nga vendi i tyre drejt zonave pritëse.

- Institucionet e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të dhe shoqërinë civile, duhet të gjenerojnë strategji dhe të hartojnë një plan pilot për të rritur cilësinë e arsimit në Kosovë.
 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet të zbatojë reforma të reja në kurrikulat, arsimin profesional, udhëzimin e karrierës dhe zhvillimin e aftësive, si dhe të përpiqet të harmonizojë kurrikulat arsimore me nevojat e sektorit privat në Kosovë.
 - MASHT duhet të punojë për të trajtuar infrastrukturën e dobët në shkolla, cilësinë e dobët e programeve arsimore, mungesën e materialeve studimore dhe klasat e mbipopulluara, të cilat që të gjitha konsiderohen si pengesa të mëdha nga të rinjtë.
 - Të rinjtë inkurajohen që të marrin pjesë në takime, debate dhe dizajnime të ndryshme të kurrikulave për të shprehur opinionet e tyre dhe për të kontribuar në procesin e rritjes së cilësisë së arsimit.
 - Duke ditur se 33% e të anketuarve nuk kanë dëgjuar për aftësimin profesional, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të dhe shoqërinë civile, duhet të gjenerojë fushata për të promovuar aftësimin profesional.
- Institucionet e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të nxisin diskutime të hapura për marrëdhëniet ndëretnike dhe të nxisin bashkëpunimin mes të rinjve të etnive të ndryshme, duke pasur parasysh që 27% e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara.
- Institucionet e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të zhvillojnë një program të ri të ndërhyrjeve kundër të gjitha llojeve të ekstremizmit, të raportuara në nivele të larta nga të rinjtë në këtë studim.

Referencat:

Friedrich Ebert Stiftung (2012). Studimi i Rinisë në Kosovë: Me sytë nga e ardhmja, të bazuar në traditë. Prishtinë: IDR Kosovë.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (2009). Projekti i Zhvillimit të Shkathtësive dhe Punësimit të të Rinjve në Kosovë* (Fazat I dhe II). Marrë nga <http://www.unkt.org/wp-content/uploads/2016/08/Project-Skills-Development-.pdf> (qasja e fundit: mars, 2018).

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2015). Vlerësim i numrit të popullsisë së Kosovës 2011. Marrë nga: <http://ask.rks-gov.net/en/add-news/estimate-on-the-number-of-kosovo-population-2011/>.

Myha, D. (2013). Papunësia e të Rinjve në Kosovë. Marrë nga http://www.demas.cz/wp-content/uploads/2014/02/IVF_Drenusha-Myha_Policy-paper_The-Youth-unemployment.pdf (qasja e fundit: mars, 2018).

UNDP në Kosovë (2006). Rinia Një brez i ri për një Kosovë të re. Raporti i zhvillimit njerëzor.

Misioni i OKB-së në Kosovë (2017). Raporti i përmbledhur për Kosovën: Konsultimi për studimin e progresit për rininë, paqen dhe sigurinë. Marrë nga: <https://www.youth4peace.info/system/files/2017-11/2017.11.16%20-%20Report%20-%20Kosovo%20Consultation%20on%20Youth%2C%20Peace%20and%20Security%20%5Bunder%20UNSC%20Resolution%201244%20%281999%29%5D.pdf> (qasur në: mars, 2018).